

▶ PËR TË GJITHË TË INTERESUARIT QË DËSHIROJNË TË BËHEN PJESË E SAMITIT TË DYTË TË DIASPORËS, PROCESI I REGJISTRIMIT "ON-LINE" ËSHTË ENDE I HAPUR. REGJISTRIMI KRYHET NË FAQEN ELEKTRONIKE TË SAMITIT.




▶ SAMITI I DIASPORËS EDHE SI NJË MUNDËSI PËR TË VIZITUAR TIRANËN, DHE MË SHUME ME "UDHËRRËFYESIN" E SAMITIT TË DYTË TË DIASPORËS PËR PJESËMARRËSIT E TIJ.




▶ SAMITI I DIASPORËS DO TË SHOQËROHET EDHE ME NJË KALENDAR TË PASUR AKTIVITETESH. PËRGJATË TRE DITËVE PJESËMARRËSIT DO TË KENË MUNDËSI TË NDJEKIN NJË SËRË EVENTESH TË PËRGATITURA NË QYTETET E TIRANËS DHE LEZHËS.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRI I SHTETIT PËR DIASPORËN

# NEWSLETTER E DIASPORËS

AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS

FONDI SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN E DIASPORËS

QËNDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN

#5

PËRFAQËSIMI DHE NXITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE TË NDËRVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT, DUKE NXITUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHTETET KU ATA BANOJNË

## Publikohet programi Shtetëror i Aktiviteteve për Diasporën Shqiptare




Programi shtetëror i Aktiviteteve për Diasporën është dokumenti i parë i këtij natyre në zbatim të Strategjisë Kombëtare të Diasporës. Ky kalendar përmban aktivitetet e programuara për gjatë vitit 2019 kushtuar interesave të Diasporës, nga institucionet e shtetit shqiptar.

Çdokush tashmë do të ketë informacion dhe mund të vendos në axhendën personale pjesëmarrjen në aktivitete që iu përgjigjen interesave apo distancës nga vendbanimi i tyre. Programi Shtetëror i Aktiviteteve për Diasporën Shqiptare duke qenë eksperienca e parë administrative e kësaj natyre, në vijimësi do të vazhdojë të pasurohet me aktivitete të tjera. Programin e detajuar mund ta gjeni në link-un e mëposhtëm: https://online.flippingbook.com/view/352287




## Mbledhja e radhës e Këshillit Drejtues të Agjencisë Kombëtare të Diasporës, diskutohet buxheti i 2019

Këshilli Drejtues i Agjencisë Kombëtare për Diasporën mbajti ditën e sotme mbledhjen e radhës e cila u drejtua nga kryetari i këtij këshilli z. Etjen Xhafaj, zv.minister për Evropën dhe Punët e Jashtme. Gjatë kësaj mbledhje u diskutua lidhur me detajimin e planit buxhetor për vitin 2019. Ndërsa Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë, z. Dritan Delija prezantoi materialin e përgatitur me informacione mbi organizimin e Samitit të dytë të Diasporës, i cili do të mbahet në datat 28 shkurt – 2 mars 2019.

Një nga pikat ku u ndal diskutimi i sotëm ishte edhe përzgjedhja e kandidatëve për Këshillin Koordinues të Diasporës të përcjella nga ambasadat e Republikës së Shqipërisë nëpërmjet Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme si dhe propozimet për dhënien e çmimit "Ambasador i Kombit".




## Përfaqësues të institucioneve shtetërore përgjegjëse për marrëdhëniet me Diasporën zhvilluan një vizitë studimore në Romë



Përfaqësues të institucioneve shtetërore përgjegjëse për marrëdhëniet me Diasporën zhvilluan një vizitë studimore në Romë me qëllim marrjen dhe shkëmbimin e përvojës për rritjen e kapaciteteve të qeverisë, institucioneve e agjencive shqiptare për angazhimin e Diasporës në zhvillimin e vendit. Vizita u zhvillua në kuadër të programit "Angazhimi i Diasporës Shqiptare në Zhvillimin Social dhe Ekonomik të Shqipërisë". Gjatë vizitës, përfaqësuesit e institucioneve shqiptare zhvilluan takime e konsultime teknike dhe shkëmbyen përvoja me përfaqësues të institucioneve dhe organizatave italiane që trajtojnë çështjet e Diasporës.




## Grupi i koordinatorëve të institucioneve përgjegjëse duke diskutuar mbi organizimin e Samitit të Dytë të Diasporës





